



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0968

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vjosa Gradinaj-Mexhuani si paneliste individuale, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Kompania e Sigurimeve "SCARDIAN" J.S.C., kundër Vendimit për dhënie të kontratës të KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi dhe kontrollimi teknik i automjeteve te Komunës se Prishtinës dhe KPSH-se” me numër të prokurimit 616-23-5923-2-1-1, me datë 23.02.2024 merr këtë:

Vendim

I. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE Kompania e Sigurimeve "SCARDIAN " J.S.C. me nr. 2023/0968, e datës 01/12/2023, kurse vendimi i KUVENDI TË KOMUNËS SE PRISHTINËS na cilësia e saj si Autoritet kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi dhe kontrollimi teknik i automjeteve te Komunës se Prishtinës dhe KPSH-se” me numër të prokurimit 616-23-5923-2-1-1 anulohet kurse nëse AK ka interes mund ta ritenderoj.

II. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

III. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Kompania e Sigurimeve " SCARDIAN " J.S.C.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 12.06.2023 ka publikuar Njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi dhe kontrollimi teknik i automjeteve të Komunës së Prishtinës dhe KPSH-se” me numër të prokurimit 616-23-5923-2-1-1. Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për shërbime dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 175.000.00€.

Me datë 07.11.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë Grupin e operatoreve ekonomik Kompania e Sigurimeve EUROSIG Sh.A., Autocon Sh.p.k.

Me datë 10.11.2023 operatori ekonomik ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin B58 të Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 22.11.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Me datë 01.12.2023 operatori ekonomik ankues ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2023/0968.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nënparagrafin 75 të LPP.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë dhe ka caktuar seancë dëgjimore me palet në kuptim të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP ku prezent ishin Autoriteti kontraktues, Operatori ekonomik, dhe eskeprti shqyrtues.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë parashtruar përmes ankesës si në vijim:

Ankuesi fillimisht sqaron se duke u bazuar në vendimin e datës 22.11.2023 në të cilën AK e shpall ankesën tërësisht si të pabazuar, duke mos e marrë parasysh vendimin e ekspertit dhe vendimin e OSHP që ankesa jone ka qenë pjesërisht e bazuar dhe që njoftimin mbi vendim të Rivlerësohet, AK ka vazhduar në vendimin e njëjtë duke e shpall fitues prap kompaninë Eurosig. AK në përpilimin e specifikimeve teknike ka bërë shkelje duke i vendosur specifikimet në mënyrë që të ve në lajthitje OE në mënyrë që kompania Eurosig të jete me çmim më të ulët pasi që këtë kontratë e ka pas në vitin paraprak dhe i ka poseduar të gjitha informatat e nevojshme për llogaritjen e çmimeve të automjeteve. Kompania Eurosig nuk është bazuar në specifikimin

teknik te cilin e kemi pasur edhe ne por ka vendosur çmime ne shkelje te tarifave te aprovuara ne BQK.”

Pretendimi i parë (I) “Mosrespektimi i Specifikimeve Teknike nga kompania EUROSIG Sh.a - Sipas sqarimit ne vendimin e marr nga AK çmimi i sigurimit TPL është pesha max. e ngarkese se lejuar (ne këtë rast sipas specifikave Pesha max e lejuar 18000 duke e minusuar Pesha pa ngarkese 9600 del çmimi për peshen max te ngarkesës qe ne rastin konkret është 8400 – çmimi sipas tarifës 535.72 EUR. Duke e krahasuar përshkrimin ne specifikacion na qon ne lajthitje për shkak qe ne kemi jep Çmimin duke u bazuar ne Pesha max. e lejuar ne specifikacione teknike siç e potencon edhe certifikata e regjistrimit te automjetit. Pesha ne libreze –I referohet përshkrimit ne dosje Pesha max e lejuar Pesha e automjetit ne libreze – I referohet përshkrimin ne dosje Pesha pa ngarkese. Ndërsa Pesha max e ngarkesës se lejuar ne ju kemi referuar si Pesha max. e lejuar, ndërsa OE Eurosig I është referuar si Pesha max e lejuar minus Pesha pa ngarkese, qe nënkupton qe nuk është I qarte përshkrimit te cilës ju ka referuar ne dosje te tenderit dhe është bere qe te arrihet çmimi me I ulet për këto automjete qe janë me peshe bartese. Për veturën e njëjtë nga ana jone është jep çmimi ne vlere 896.80 EUR sipas Peshës max te lejuar 18000 ne dosje te tenderit.” Pretendimi i dytë (II) “Autoriteti Kontraktues ka shpallur fituesin e prokurimit duke u bazuar në sqarimet e marra nga BQK-ja sipas vendimit te dt. 22.11.2023. Ne dëshminë qe na është dorëzuar (email I bashkangjitur ne këtë ankese) AK ka kërkuar nga BQK qe te ja përcjell linkun e tarifave zyrtare për kompanitë e sigurimit Jo-jete por nuk ka kërkuar se a janë te obliguara kompanitë e Sigurimit ti respektojnë tarifat te cilat janë te aprovuara nga Banka Qendrore. Ne përgjigjen e BQK-se ne fjalinë e pare ka thënë: Te gjithë siguresit Jo-Jete janë te obliguar qe ti respektojnë tarifat e autopergjigjesise MTPL te aprovuara nga BQK te cilat janë te publikuara ne web faqen e BQK-se. D.m.th. Banka Qendrore ka sqaruar qe për çdo klase te Sigurimit te autopergjigjesisë tarifat duhet te vendosen ne baze te specifikimeve te automjetit.”

Autoriteti konktaktues në seancën e mbajtur shkurtimisht ka deklaruar pas ankese se par ne komisionin e dytë për rivlerësim kemi kërkuar sqarime ne lidhje me sigurimet dhe të njëjtën dit na kanë kthyer përmes imelles që të gjitha tarifat janë unike dhe secila çmimet i kanë unike ne terë Kosovën andaj rrejdhimisht qendron prapa vendimit të tij/saj dhe në asnjë rethanë oepatori ekonomik me qmimin e ofruar sipas ofertës se tij nuk mund ta ekzekutoj kontraten në fjal.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, OSHP me datë 07.12.2023 ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues. Me datë 12.12.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si në vijim: “ ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimit për kontratë dhe nëse AK më tutje ka interes, aktivitetin e prokurimit ta ritenderojë.” Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit ndërsa OE nuk është deklaruar rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimet e OE Kompania e Sigurimeve "SCARDIAN " J.S.C. " përmes raportit nr. 2023/0968 dhe në seancën e mbajtur ka deklaruar si në vijim:

Aktiviteti në fjalë është rivlerësuar me vendim të OSHP-së PSH.nr: 2023/0672, dhe si rrjedhojë me datë 07.11.2023 gjatë procedurës së rivlerësimit, AK publikon njoftimin B58 me të cilin rekomandon të njëjtin OE Eurosig Sh.a, ndërsa OE ankuesin e shpallë të pa suksesshëm. Ekspertja shqyrtuese duke u gjendur në një situatë të tillë, meqenëse krahas tarifave të BQK-së ka dallime në çmimet e ofuara nga OE i rekomanduar, fillimisht kërkon sqarim me

datë 11.12.2023 me email në BQK-Departamenti i Sigurimeve, duke ju kërkuar që të sqarojnë se si bëhet llogaritja e tarifës krahasuar me tarifën e dhëna nga kompanitë e sigurimeve Eurosig sh.a dhe Scardian JSC në BQK. BQK me datë 13.12.2023 ka sqaruar se citat:” Kamionët që ngarkohen llogariten për ngarkesën që mund të bartin, prandaj pasi në tarifën e BQK-së nuk është e specifikuar për kamionë special (në këtë rast zjarrfikës), duhet të llogaritet duke ia zbritur peshën pa ngarkesë, pra të tariforet vetëm për ngarkesën që bartë.”

Ekspertja shqyrtuese pas verifikimit të tarifave të BQK-së, duke i krahasuar me ofertën e OE të rekomanduar vetëm pozicionet/pikat e atakuara nga OE ankues (10,11,12,13,14,15,16,18,19,21,23,26,27,28,29,34 dhe 35) konsideron se,OE i rekomanduar në pikat 10, 21,23,27 ka dallim tarifa me ofertën, pra ekspertja shqyrtuese ka kalkuluar sipas sqarimit të BQK-së, d.m.th. kamionët special në rastin konkret kamionët e zjarrfikësve, janë verifikuar duke ia zbritur peshën e ngarkuar nga pesha maksimale, mirëpo siç sqaruam edhe më lartë pikat e lartpërmendur, nuk përkojnë çmimet në ofertë me tarifën e BQK-së dhe krahasimi me paramasë të AK-së, andaj si e tillë pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.

Vlen të theksohet se, gjatë analizimit të çmimorës për pikat në pretendim, kemi ftuar në takim gjithashtu edhe një anëtar të komisionit-AK, duke kërkuar sqarime se nëse ka ndonjë shpjegim lidhur me çmimet e ofruara nga OE i rekomanduar, ku ky i fundit pas verifikimit të pikave, konkludojmë s’bashku, se pikat 10, 21, 23, 27 kanë dallime në çmimore me tarifën e BQK-së. Për të cilat pika meqë kishim dilema, atëherë kam parashtruar e-mail pranë Byrosë Kosovare të Sigurimeve (BKS), duke kërkuar nga të njëjtët që të na qartësojnë këto çmime. BKS ka sqaruar se çmimoren dhe tarifën për këto pika të kontestuara duhet ti referohemi librezave, sepse në paramasën e dërguar nuk mundet të verifikohet. Tutje, kam kërkuar nga AK që të na bashkangjiten librezat, me qëllim që ti krahasojmë se a përputhen të dhënat në paramasë me librezat, dhe si e tillë vërejmë se ka mos përputhje. Si përfundim, pas analizimit të shkresave të lëndës, pretendimet e OE ankues, sqarimet nga BQK, sqarimet nga BSK, bazuar në argumente dhe fakte, konsideroj se ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet konform nenit 43.5 pika b.” asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm”, për faktin se, ne pasi kemi kërkuar nga AK që për pikat kontestuese të na sigurohen librezat, aty kemi vërejtur se, AK ka vendosur një paramasë (të dhëna) të cilat nuk përkojnë plotësisht me të dhënat në librezat fizike të automjeteve, i cili informacion pastaj ndryshon çmimin e ofertuesve në ofertat e tyre, dhe si e tillë rezulton se nuk ka oferta të përgjegjshme.

- Konstatimet e Panelit Shqyrtues -

Sipas të dhënave më sipër, ekspertja shqyrtuese i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e ankuesit OE ‘Scardian’. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertës shqyrtuese mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit dhe dokumentet e tjera. Prandaj në kontekstin fakteve, rrethanave dhe provave të administruara, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin raportit të ekspertës shqyrtuese. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara. Ngase në bazë të hulumtimeve dhe analizave të ekspertës shqyrtuese, është vërejtur një dallim i qartë në vlerat tarifore midis atyre të publikuara nga Banka Qendrore e Kosovës dhe atyre të ofruara nga Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, ekspertja shqyrtuese ishte drejtuar tek Departamenti i Sigurimeve në BQK për të kërkuar sqarime mbi metodologjinë e llogaritjes së tarifave, veçanërisht për tarifën e ofruara nga kompanitë e sigurimeve "Eurosig" sha dhe "Scardian" JSC. Përgjigjja e BQK-së theksoi se tarifimi për kamionët speciale duhet të bëhet

duke zbritur peshën bazë, dhe jo duke tarifuar për peshën totale të tyre.

Po ashtu, nga ky raport kuptohet se ekspertja shqyrtuese ka kërkuar nga AK dhe librezat e automjetit [duke i pasur parasysh shpjegimet e BKS] me qëllim që ti krahasojë se a përputhen të dhënat në para-masën e publikuar nga AK me librezat fizike të automjeteve dhe si rezultat ka konstatuar se tarifat e OE të rekomanduara për kontratë në raport me ato të bëra publike nuk përputhen. Në këtë rast, ekspertja shqyrtuese shkurtimisht ka konstatuar se cituar: “AK ka vendosur një para-masë (të dhëna) të cilat nuk përkojnë plotësisht me të dhënat në librezat fizike të automjeteve, i cili informacion pastaj ndryshon çmimin e ofertuesve në ofertat e tyre dhe si e tillë rezulton se nuk ka oferta të përgjegjshme” kurse në vijim ka rekomanduar cituar “ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet konform nenit 43.5 pika b.” asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm”.

Pas seancës publike të mbajtur me datën 05.02.2024, OSHP ka kërkuar përsëri sqarime nga AK lidhur me përpilimin e paramasës në krahasim me të dhënat në librezë, pasi pesha 3700 shembuj në pozicionin 10 nuk shfaqet në librezë. AK ka kthyer përgjigje, duke thënë se Brigada Profesionale e Zjarrfikjes në Prishtinë ka një sërë automjeteve në pronësi, disa prej tyre donacione nga jashtë vendit, dhe për shkak të kësaj kanë hasur vështirësi në regjistrimin e tyre për një kohë të gjatë. Përveç kësaj, kanë ndodhur lëshime dhe gabime teknike gjatë plotësimit të dokumentacionit, duke përfshirë edhe probleme nga Qendra e Regjistrimit të Automjeteve, Kontrollit Teknik dhe QAK. AK thekson se nuk ka pasur qëllim të bëjë ndonjë lëshim, por vështirësitë me dokumentacionin e automjeteve, disa prej të cilave janë donacione me dokumente të pa kompletuara, mund të ketë sjellë gabime në disa të dhëna në librezë gjatë procesit të ndërrimit të tyre.

- Përfundim -

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, ka vlerësuar të gjitha provat në dispozicion të shkresave të kësaj lënde dhe konsideron se autoriteti kontraktues nuk ka vepruar në harmoni me parimet bazë të LPP, meqë krijohet bindja e pavarur se AK ka vendosur një para-masë (të dhëna) të cilat nuk përkojnë plotësisht me të dhënat në librezat fizike të automjeteve duke reflektuar në vlera të ndryshme tarifore për ofertuesit. Andaj nisura nga shpjegimet si më sipër, posaçërisht duke ju referuar raportit të ekspertit shqyrtues dhe faktit se sipas përgjigjes së AK nuk është kontestuese se me të vertetë kanë ndodhur gabime në përpilim të kësaj paramasë, Paneli krijoi bindjen se ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet konform nenit 62 dhe 43.5 pika b. të LPP, sipas të cilit sipas ekspertit ka rezultuar se cituar: “ asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm” Megjithatë, autoriteti kontraktues ka mundësinë të ri-tenderojë aktivitetin nëse e konsideron të rëndësishëm për të përmbushur nevojat e institucionit, por gjithmonë duke i respektuar kriteret dhe dispozitat e LPP që rregullojnë përpilimin e dosjes së tenderit. Është thelbësore që AK të marrë parasysh me kujdes nevojat aktuale të institucionit dhe të përpilojë paramasat e tenderit në përputhje me Nenin 1 dhe Nenin 7, 27 dhe 28 të LPP, duke siguruar kështu një proces të drejtë, efikas dhe transparent për të gjithë pjesëmarrësit. Sepse kjo do të sjellë në një mjedis konkurrues dhe të drejtë për secilin operatorë ekonomik.

Rrjedhimisht pas një analize të kujdesshme të të gjitha provave, Paneli Shqyrtues ka vendosur që ankesa e Operatorit Ekonomik të pranohet pjesërisht dhe që aktiviteti i prokurimit të anulohet në tërësi. Ky vendim është mbështetur në parimet e barazisë dhe drejtësisë në prokurimin publik si dhe në rimbursimin e tarifës së ankesës sipas pikës dy të dispozitivit të këtij vendimi sepse askush sipas gjykimit të pavarur të këtij paneli nuk duhet të penalizohet padrejtësisht për gabimet

dhe/ose paqartësit e aplikuara në DT nga një Autoritetit publik kontraktues.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoritetit Kontraktues që i njëjti të ushtroj një vëmendje të lartë në zbatimin e procedurave të prokurimit publik e cila përfshin respektimin e plotë të udhëzimeve dhe normave të parashikuara në Ligjin për Prokurimet Publike dhe në legjislacionin dytësor përkatës që mbulon sferën e prokurimeve publike duke garantuar që çdo veprim dhe vendim i marrë nga cilësia e saj si Autoriteti Kontraktues të siguroj që proceset e prokurimit të zhvillohen jo vetëm në përputhje me ligjin e cituar, por edhe në mënyrën më të drejtë dhe transparente që është e mundur. Ngase qasja e tillë kontribuon në mbrojtjen e integritetit të procesit të prokurimit dhe në forcimin e besimit të ofertuesve dhe të gjithë publikut në sistem.

Paneli Shqyrtues, duke vepruar nën autoritetin që i është dhënë nga Ligji për Prokurimin Publik (LPP), ka përdorur të gjitha kompetencat e veta ligjore për të siguruar procedurë të shqyrtimit të prokurimit e cila është e shpejtë, e drejtë, pa diskriminim dhe e orientuar drejt gjetjes së zgjidhjeve ligjore dhe efikase për çështjet në fjalë. Kjo qasje reflekton një angazhim të thellë ndaj parimeve të barazisë, transparencës dhe drejtësisë në menaxhimin e proceseve të prokurimit publik në përputhje me nenin 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP .

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Kompania e Sigurimeve " SCARDIAN " J.S.C.**
- Arkivës së OSHP-së: